

Një Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë **2024**

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Prill 2025

Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.



Përmbajtja

- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet
- Tregues Monetar
- Renditja Ndërkombëtare



TREGUES KRYESORE MAKROEKONOMIKË

- Rritja e PBB-së në 2024 vlerësohet në 3,96%. Rritja tremujore (TM42024) ishte 3,63%, e nxitur kryesisht nga shërbimet publike, tregtia, pasuritë e paluajtshme dhe ndërtimi, ndërsa industria dhe bujqësia kontribuan negativisht. Perspektiva e rritjes së Shqipërisë është e moderuar në krahasim me rajonin – pritet të arrijë në 3,5% deri në vitin 2026.
- Investimet e Huaja Direkte (IHD-të) arritën në 1,6 miliardë euro në 2024, +5,6% në vit. Stoku u rrit me 16%, duke arritur në 62,1% e PBB-së. Burimet kryesore: Turqia, Italia dhe Holanda. Pasuritë e paluajtshme janë sektori kryesor për investitorët e huaj ndërsa bujqësia tërheq më pak.
- Paga mesatare mujore u rrit me 18% në vitin 2024, duke arritur në 83.401 lekë. Pagat e sektorit publik u rritën më shpejt se privati. Paga minimale është 40.000 lekë.
- Inflacioni në vitin 2024 ishte mesatarisht 2,2%, nga 4,8% në 2023. Inflacioni është rikthyer nën objektivin e Bankës së Shqipërisë (3%) që nga shkurti 2024.
- Papunësia në TM4 2024 ishte 8,8%, më e lartë tek femrat. Produktiviteti i punës mbetet i ulët, veçanërisht në bujqësi dhe shërbime.
- Eksportet ranë me 15.4% në 2024; kryesisht nga mineralet, lëndët djegëse, tekstilet dhe metalet. Importet u rritën me 2,5%, veçanërisht në makineri dhe ushqime. Deficiti tregtar u zgjerua me 20,7%, ku eksportet mbuluan vetëm 41,7% të importeve. Partnerët kryesorë tregtarë: Italia, Kina, Turqia dhe Greqia.




VLERËSIMI SIPAS INDEKSEVE BOTËRORE

- ❑ *Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit: Pozicioni 80/180, përmirësim me 5 vende nga një vit më parë*
- ❑ *Indeksi i Lirisë Ekonomike: Vlera indeksit 66.6, vendi 50-të/177 në nivel ndërkombëtar*
- ❑ *Indeksi Global i Inovacionit: Pozicioni 84/133, i fundit në rajon*
- ❑ *Kompleksiteti Ekonomik: Pozicioni 83/133, pas Bosnjës dhe Serbisë*
- ❑ *Përgatitja Teknologjike: Pozicioni nën mesataren*
- ❑ *Indeksi i Infrastrukturës së Cilësisë: Pozicioni 59/156*


ECURIA E RRITJES EKONOMIKE

Rritja Ekonomike, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019 dhe ra përgjatë vitit 2020 me -3,3%, rënie më e vogël krahasuar me parashikimet fillestare, si rezultat i pandemisë COVID19. Gjatë 2024 rritja vlerësohet 3,96% bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT.


RER, Banka Botërore pranverë 2025




Bazuar në vlerësimet e BB, gjatë vitit 2024, Kosova vlerësohen me rritjen më të lartë prej 4,4%. Rritja më e ulët vlerësohet në Maqedoninë e Veriut me 2,8%. BP vlerësohet me një rritje mesatare prej 3,4% përgjatë periudhës 2025-2026, ku rritja më e lartë do të regjistrohet kryesisht në Serbi dhe Kosovë.

ECURIA E RRITJES EKONOMIKE

Vlerësimi i rritjes ekonomike Shqipëria 2024




Vlerësimi Rritja ekonomike Shqipëria 2025 - 2026



Bazuar në të dhënat paraprake të INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto gjatë vitit 2024 në Shqipëri u rrit me 3,96%, rritje më e lartë sesa parashikimet e institucioneve ndërkombëtare apo edhe të Qeverisë Shqiptare.

Institucionet ndërkombëtare japin një parashikim më të ulët të rritjes ekonomike për periudhën 2025 - 2026, krahasuar me parashikimet e Qeverisë Shqiptare.

RRITJA EKONOMIKE SIPAS TREMUJORËVE




Produkti i Brendshëm Bruto, në terma realë, në tremujorin e katërt të vitit 2024 vlerësohet me rritje 3,63 %, në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2023. Kontribut pozitiv kanë dhënë degët: “Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia” me +1,44 p.p, “Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor” me +0,81 p.p, “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me +0,50 p.p, “Ndërtimi” me +0,25 p.p, “Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi” me +0,19 p.p, “Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit” me +0,03 p.p, “Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative” me +0,01 p.p. Aktiviteti “Industri, Energji dhe Uji” kontribuoi me -0,85 p.p, “Bujqësi, Pyje dhe Peshkim” me -0,35 p.p dhe “Informacioni dhe Komunikacioni” me -0,01 p.p.


E ARDHURA PËR FRYMË

Për vitin 2023, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **8.575 USD** në vlerë korrente, më lart se një vit më parë.

Produkti i Brendshëm Bruto për frymë (USD/frymë)




2023 Të ardhurat për frymë



Burimi: World Development Indicators

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME




Gjatë vitit 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 373 mld lekë, duke u ulur me -15,4 %, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 894 mld lekë, duke u rritur me 2,5 %, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën 522 mld lekë, duke u rritur me 20,7 %, krahasuar me vitin 2023.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve ra në 41,7% nga 50,4% në 2023.

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Importe në vite, milionë lekë



Gjatë vitit 2024, importet janë rritur me 2,5 %, krahasuar me vitin 2023.


Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë:

- “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,9 p.p,
- “Ushqime, pije, duhan” me +1,2 p.p, etj.

Ndërsa kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,0 p.p, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 p.p, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,3 p.p.

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Eksporte në vite, në milionë lekë




Eksportet, gjatë vitit 2024 janë ulur me -15,4 %, krahasuar me një vit më parë.

Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,1 pikë përqindje.

IMPORTET E MALLRAVE


Struktura e importeve të mallrave gjatë 2024 dominohet kryesisht nga Makineri pajisje dhe pjesë këmbimi e cila është rritur ndër vite, dhe Ushqime, pije, duhan, e cila qëndron konstante përgjatë viteve.

Importet sipas produkteve



EKSPORTET E MALLRAVE

Eksporte sipas produkteve




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre të njëjtë me vitin e kaluar.

Ndërkohë, në vështrim të ecurisë nga 2016-2024, vihet re konsolidim i uljes së përqindjes ndaj totalit të eksporteve të grupit “Tekstile dhe këpucë” dhe një rritje të eksporteve sidomos në grupin Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi.

Burimi: INSTAT

QARKULLIMI I MALLRAVE-SIPAS VENDEVE PARTNERE

Eksporte sipas vendeve kryesore partnere, në milion lekë




Shkëmbimet tregtare, për vitin 2024, me vendet e BE-së zënë 57,4 % të gjithë tregtisë. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,8 %), Kina (8,5 %), Turqia (8,0 %) dhe Greqia (7,2 %)

Në 2024 eksportet drejt vendeve të BE-së përbënin 71,7 % të eksporteve gjithsej.

Vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve gjatë 2024, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (13,9 %), Kosova (9,8 %), Greqia (18,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (3,5 %), etj.

QARKULLIMI I MALLRAVE-SIPAS VENDEVE PARTNERE

Importe sipas vendeve kryesore partnere, në milionë lekë





Në periudhën janar–dhjetor 2024 importet nga vendet e BE-së zënë 51,5 % të importeve gjithsej.

Në 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (4,2 %), Turqia (14,2 %), Greqia (19,7 %), etj.

Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (2,3 %), Maqedonia e Veriut (14,9 %), Zvicra (29,8 %), etj.


EKSPORTET NË SHËRBIME KONTEKSTI RAJONAL



Edhe gjatë vitit 2023, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve. Ndërkohë Shqipëria ka përmirësuar disi renditjen në rajon përsa i përket eksportit në Shërbime ICT.

IMPORTE NË UDHËTIME KONTEKSTI RAJONAL

Importet në udhëtime (% ndaj Importeve në Shërbime)




Shqipëria renditet e para në rajon përsa i përket % së importeve në udhëtime ndaj importit të shërbimeve.

Gjatë 2023 ky tregues ishte 72,7% (në rënie nga viti i kaluar) e totalit të importit të shërbimeve. Vendi i dytë në radhë është Kosova me 46,8% e ndjekur nga Bosnia dhe Hercegovina me 33,6%.

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2024 është 2,2% nga 4,8% që ishte në vitin 2023.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendeca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji Nëntor 2021, ku Inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH dhe arriti kulmin në muajin tetor 2022, me 8,3%. Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2024, inflacioni ra nën objektivin e BSH prej 3%.

KURSI I KËMBIMIT


Ecuria e kursit të këmbimit, USD/ALL, EURO/ALL




Përgjatë vitit 2024, kursi mesatar i këmbimit lekë/Euro ishte 100,7 ndërsa lekë/USD ishte 93.

KREDIA PËR EKONOMINË

Kredia për ekonominë, në milionë lekë



Kredia e re për ekonominë, 2024 (mld lekë)




Kredia totale për ekonominë arriti në 834,7 miliardë lekë në dhjetor 2024, 12% rritje krahasuar me dhjetor 2023. Ndërkohë, shumica e kredisë së re gjatë vitit 2024 shkoi sërisht drejt tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndërtimit dhe industrisë përpunuese.

Burimi: BSH

FORCA E PUNËS


Norma e papunësisë




Në Tremujorin IV 2024, bazuar në të dhëna paraprake shkalla e papunësisë regjistroi shifrën 8,8% për popullsinë 15+, më e lartë tek femrat (9,6%) sesa tek meshkujt (8%).

PAGA MESATARE SIPAS SEKTORËVE (NË LEKË)

Paga mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve kryesore (lekë)



Hendeku gjinor ne Paga (%)




Në 2023, pagat më të larta janë regjistruar në sektorin e Veprimtarive të organizatave ndërkombëtare, “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”, trend i konsoliduar tashmë. Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”. Gjatë 2023 vihet re rritje e pagës mesatare të raportuar në të gjithë sektorët, (mesatarisht 14%). Rritja më e lartë regjistrohet tek aktivitetet Shërbime në Shtëpi, Pasuri të Patundshme dhe Administrata Publike. Hendeku gjinor në paga në Shqipëri vlerësohet në +6,2% për vitin 2023.

Burimi: INSTAT

Paga mesatare mujore është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer. Hendeku gjinor në paga i referohet diferencës në paga mesatare midis meshkujve dhe femrave.

PAGA MESATARE DHE PAGA MINIMALE

Paga bruto në lekë




Paga mesatare gjatë TIV 2024 është raportuar në **83.401 lekë** nga 70.539 në vitin 2023, me rritje 18% krahasuar me pagën e raportuar në 2023..

Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **76.000 lekë**, 16% rritje krahasuar me vitin 2023 ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror u raportua në **100.437 lekë**, me një rritje **23%** krahasuar me shifrën e vitit 2023.

Paga minimale u rrit në **40.000 lekë** nga TII 2023.

KOSTO E PUNËS PËR VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Pagat mesatare për një të punësuar në Ballkanin Perëndimor (EURO)




Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon së bashku me Kosovën.


Burimi: Zyrat statistikore të vendeve

VLERA E SHTUAR PËR PUNONJËS

Vlera e shtuar/punonjës, Industria (përfshi Ndërtimin) (USD konstant 2015)




Vlera e shtuar/punonjës, Shërbime (USD konstant 2015)



Diferencat më të mëdha në produktivitetin e punës shfaqen në sektorin e Bujqësisë, pyjet dhe peshkimi ku Mal i Zi shfaqet dukshëm më produktivitet më të lartë.

Shqipëria renditet e fundit në rajon, përse i përket produktivitetit të punës në Bujqësi dhe Shërbime.


Vlera e shtuar/punonjës Bujqësia, pyjet, Peshkimi (USD konstant 2015)



Burimi: WDI

INVESTIMET PUBLIKE, PRIVATE DHE IHD

Investimet Publike, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks and IHD





Formimi bruto i kapitalit fiks regjistroi shifrën 24,1% gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023, Investimet publike arritën 5,1% të PBB, kurse Investimet e Huaja Direkte 6,4% të PBB.

Remitancat në 2024 regjistruan shifrën 1.045 million Euro, sa 4,4% e PBB.



INVESTIMET PRIVATE NË EKONOMI



Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2023, investimet private ranë me 5,6%; ndërkohë vërehet rënie e investime tek ndërmarrjet prodhuese të të mirave dhe rritje e investime tek prodhuesit e shërbimeve. Kryesisht investimet gjatë vitit 2023 kanë shkuar për Makineri dhe Pajisje me rritje nga një vit më parë.

Burimi: INSTAT Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE



Gjatë vitit 2024, fluksi hyrës i IHD u rrit me 5,6% krahasuar me një vit më parë. Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qenë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD-ve në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri ne TIV 2019 dhe ka filluar sërish rimëkëmbjen gjatë TII 2020. Gjatë vitit 2024, flukset e IHD arritën 1.583 mln Euro, 853 milionë Euro janë fitimet e riinvestuara të cilat kanë pësuar rritje duke filluar nga viti 2017.

Ndërkohë, gjatë vitit 2024, stoku i IHD u rrit me 16% krahasuar me një vit më parë duke arritur 15.412 milionë Euro.


Burimi: Banka e Shqipërisë

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Investimet e Huaja Direkte, në % PBB




IHD stoku si % ndaj PBB



Flukset e Investimeve të Huaja në Shqipëri ruajtën të njëjtin trend edhe përgjatë vitit 2024, 6,4% të PBB, ndërsa stoku IHD-ve arriti në 62,1% të PBB.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Fluksi IHD ne vite (në mln EURO)



Stoku IHD, sipas vendit të origjinës, në milionë Euro




Gjatë 2024, Turqia është vendi me fluksin më të lartë të IHD, 257 milionë Euro, ndjekur nga Italia dhe Holanda, respektivisht me 200 dhe 176 milionë Euro. Vërehet një rënie e flukseve hyrëse nga Holanda e cila një vit më parë udhëhiqte me 304 milionë Euro.

Ndërkohë, në TIV 2024, Holanda vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve, duke arritur në 2.544 milionë Euro e ndjekur nga Zvicra me 2.267 mln Euro.

Burimi: Banka e Shqipërisë

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE


Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, 2024 në milionë Euro



Gjatë vitit 2024, Investimet në pasuri të paluajtshme ngelen aktiviteti më i preferuar për investorët e huaj të cilët kanë investuar deri në 379 milionë Euro, 17% më shumë se një vit më parë.

Ndërkohë, Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi janë aktiviteti më pak tërheqës për investorët e huaj në vend.


FLUKSI I IHD NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Gjatë vitit 2023, Kosova udhëheq rajonin përsa i përket Flukseve të IHD-ve në raport të PBB, 8,7%. Shqipëria ndërkohë renditet e treta në rajon me 6,9% të PBB.

Në përgjithësi, flukset e IHD-ve në % të PBB kanë rënë në të gjitha vendet e BP, me përjashtim të Kosovës dhe Bosnje Hercegovinës të cilat kanë pësuar një rritje të lehtë në krahasim me një vit më parë.

FLUKSI I IHD NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Flukset hyrëse të IHD në Serbi ishin 4,9 miliardë USD për vitin 2023, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e 1,6 miliardë USD.

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD-ve në rajon për vitin 2023 është Mali i Zi me 526 milion USD.

Bosnja dhe Hercegovina ka përjetuar rritjen më të lartë të flukseve të IHD-ve me 22% e ndjekur nga Kosova me 19%. Ndërkohë Mal i Zi ka përjetuar uljen më të lartë në rajon me rreth 347 milionë USD më pak.

STOKU DHE PROFILI I NDËRMARRJEVE

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrje të vogla me 1-9 të punësuar.

Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri në të gjitha format ligjore (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare).

Treguesit	Numri i ndërmarrjeve					
Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023*
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	100,876	96,924	95,558	97,022	106,132	109,661
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	5,246	5,736	5,674	5,608	5,842	6,176
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	1,147	1,251	1,173	1,227	1,306	1,286
NVM (1-249 të punësuar)	107,269	103,911	102,405	103,857	113,279	117,123
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	181	179	169	174	181	168
Gjithsej	107,450	104,090	102,574	104,031	113,460	117,292


Treguesit	Numri i të punësuarve					
Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023*
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	194,867	196,403	186,400	191,250	206,598	212,212
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	102,950	114,451	111,347	111,318	115,007	120,564
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	113,911	122,330	114,767	121,002	128,026	129,322
NVM (1-249 të punësuar)	411,727	433,184	412,514	423,570	449,631	462,098
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	103,979	97,669	91,472	95,669	98,311	97,824
Gjithsej	515,706	530,853	503,986	519,240	547,942	559,922

Burimi: Burimi: Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve

*Të dhënat e publikuara do të jenë objekt revizionimi

PERSPEKTIVA E KONKURRUESHMËRISË SË BP - OECD

★ ALB ◆ BP6




Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme që nga Perspektiva e Konkurrencës 2021, duke përparuar pozitivisht në 14 nga 15 dimensionet e politikave dhe por ka ngecur tek dimensionin i Ndërmarrjeve Shtetërore.

Shqipëria përjetoi rritjet më të forta të rezultateve në fushat e antikorrupsionit, politikës tregtare dhe politikave bujqësore dhe e kalon mesataren e Ballkanit Perëndimor (BP6) në 13 dimensione të politikave.

INDEKSI I PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT

Indeksi i Perceptimit të korrupsionit, renditja 180 vende




Shqipëria renditet e **80/180** në rang botëror, duke përmirësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar me pesë vende. Shqipëria e ka rritur vlerësimin e indeksit nga 37 një vit më parë, në 42 për vitin 2024.

Mali i Zi ka renditjen më të mirë nga të gjitha gjashtë vendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor (65/180), i ndjekur nga Kosova (73/180).

Renditjen më të ulët e shënon Bosnja dhe Hercegovina (114/180) e ndjekur nga Serbia (105/180).

LIRIA EKONOMIKE

Liria Ekonomike, 177 vende të vlerësuara



Shqipëria vlerësohet me një indeks të lirisë ekonomike prej 66,6 duke e bërë ekonominë e saj të 50-ën më të lirë në vlerësimin më të fundit të Lirisë Ekonomike.

Vlerësimi i saj është rritur me 1,8 pikë nga viti i kaluar dhe Shqipëria renditet e 27-ta nga 44 vende në rajonin e Evropës.


Shqipëria vlerësohet Relativisht e Lirë.

Rezultatet për Indeksin e Lirisë Ekonomike bazohen përgjithësisht në të dhënat për periudhën që mbulon gjysmën e dytë të vitit t-2 deri në gjysmën e parë të vitit t-1

Burimi: www.heritage.com

12 LIRITË EKONOMIKE

12 Liritë Ekonomike




Shqipëria vlerësohet më mirë përsa i përket Kostos së Taksave dhe Lirinë e Tregut, ndërsa vlerësimin më të ulët e regjistron në Integritetin Qeverisës, Lirinë e Punës dhe e Drejta mbi Pronën.

Rezultatet për Indeksin e Lirisë Ekonomike bazohen përgjithësisht në të dhënat për periudhën që mbulon gjysmën e dytë të vitit t-2 deri në gjysmën e parë të vitit t-1

Burimi: www.heritage.com

INDEKSI GLOBAL I INOVACIONIT

Indeksi Global i Inovacionit (Renditja 133 ekonomi)




Shqipëria renditet e 84-ta/133 në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2024, e fundit në rajon dhe ka humbur një vend nga renditja në 2023.

Serbia kryeson rajonin në Inovacion (53/133) sipas raportit më të fundit të GII e ndjekur nga Maqedonia e Veriut (54/133).

INDEKSI GLOBAL I INOVACIONIT

Indeksi Global i Inovacionit, Renditja 133 ekonomitë për 2024




Shqipëria renditet ulët në Kërkim dhe Kapital Njerëzor, Sofistikim i Tregut dhe Njohuri dhe Prodhim Teknologjik dhe Prodhim Kreativ.

Më mirë Shqipëria renditet në Infrastrukturë, Institucione dhe Sofistikimin e Biznesit.

INDEKSI I KOMPLEKSITETIT EKONOMIK

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik (Renditja botërore)




Shqipëria renditet e 83a përta i përket Indeksit të Kompleksitetit Ekonomik, ndërkohë Bosnja Hercegovina renditet e 37a dhe Serbia e 40a.

Në 3 vendet e para renditen Zvicra, Japonia dhe Singapori.

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik - Rendit vendet bazuar në sa e larmishme dhe komplekse është shporta e tyre e eksportit

INDEKSI I GADISHMËRISË SË TEKNOLOGJIVE

Indeksi i gatishmërisë së teknologjive kufitare të avancuara Renditja në rang botëror, 2024



Shqipëria përfshihet në grupin e vendeve që vlerësohen **poshtë-mesatares**, në dallim nga vendet e tjera të BP të cilat klasifikohen mbi-mesataren.


BP	Vlerësimi	Renditja 2024
SRB	mbi-mesatare	48
MNE	mbi-mesatare	71
MKD	mbi-mesatare	63
BiH	mbi-mesatare	81
ALB	poshtë-mesatare	89

Indeksi i gatishmërisë së teknologjisë kufitare të avancuara tregon se sa të përgatitura janë vendet për të adoptuar dhe përshtatur teknologjitë kufitare të avancuara. Ai llogaritet nga UNCTAD dhe jep rezultate për 166 ekonomi të cilat klasifikohen në 4 grupe: e ulët, poshtë-mesatares, sipër-mesatare dhe i lartë.


Burimi: www.unctad.org

GADISHMËRIA E INFRASTRUKTURËS PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

5 Dimensionet e Indeksit Shqipëria 2024



Renditja sipas Indeksit 2024 Ballkani Perëndimor



Vlera e indeksit për Shqipërinë është 44.5, duke e renditur në vendin në vendin e 59-të/156 vendet e vlerësuara. Renditjen më të mirë në BP e ka Serbia e cila renditet e 43/156, ndërsa renditjen më të ulët e ka Mali i Zi (101/156).

Indeksi QI4SD përmbledh gjendjen e zhvillimit të gatishmërisë së Infrastrukturës së Cilësisë për të mbështetur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm